



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Mars 2021

Nr: 171

VENDIM

**PËR MIRATIMIN E SASISË SË VULAVE REZERVË TË KOMISIONIT TË
QENDRËS SË VOTIMIT QË DO TË PRODHOHEN PËR ZGJEDHJET PËR
KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 25 PRILL 2021**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, gërma “n”, dhe 2, nenin 103, paragrafët 1 dhe 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimin e Komisionit Rregullator nr. 5, datë 19.02.2021,

V Ë R E N:

Komisioni Rregullator me vendimin nr.11, datë 28.12.2020 “Për caktimin e rregullave për administrimin dhe shpërndarjen e vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit”, të ndryshuar me vendimin nr. 5, datë 19.02.2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr.11, datë 28.12.2020”, ka përcaktuar prodhimin e vulës rezervë me tekst unik për zëvendësimin e vulës së KQV-së apo vulës së Kryetarit të KQV-së, të nxjerrë nga përdorimi. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në vendimin e sipërcituar përcakton:

- a) numrin e vulave rezervë që do të prodhohen në rang vendi;
- b) formatin, tekstin dhe numrin serial të çdo vule rezervë;

Duke vlerësuar numrin e kufizuar të rasteve që ky material zgjedhor është përdorur në zgjedhjet pararendëse, sasia e vulave rezervë të KQV-ve do të jetë në raport me numrin e QV-ve. Sasia prej 600 vulash rezervë të KQV-ve, e ndarë në raportin rreth 5 vula rezervë për 30 QV, krijon një rezervë të mjaftueshme të këtij materiali zgjedhor për çdo ZAZ, për të përballuar çdo situatë që mund të diktojë përdorimin e vulës rezervë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, gërma “n”, dhe 2, nenin 103, paragrafët 1 dhe 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S A :

1. Për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, në rang vendi do të prodhohen 600 (gjashtëqind) vulat rezervë të KQV-së.
2. Formatit dhe specifikimet e vulës rezervë të KQV-së do të jenë sipas lidhjes nr.1.
3. Teksti i vulës rezervë të KQV-së është unik për çdo vulë, dhe përbëhet nga shkronja “R” dhe një numër serial katër shifro.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021

Formati i Vulës: KQV - REZERVË



Legjenda:

1. Diametri = 38 mm
2. Stema e Republikës së Shqipërisë
3. tekst: Republika e Shqipërisë
4. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
5. Komisioni i Qendrës së Votimit
6. Numri i identifikimit, tekst: REZERVË, R-0001
7. tekst: Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021